zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: Elham, për raportin e punës i përmende edhe defektet për vitin 2025–2026, edhe për konkursin e vitit të kaluar, mungesën e orëve. Është e vërtetë që kemi pasë zvarritje në konkursin e vitit të kaluar, edhe pse me vonesë mësimdhënësit i kemi marrë dhe jemi munduar thuaj se shumicën, ose në përgjithësi mund me thanë që orët janë mbuluar, dhe janë munduar mësimdhënësit që t'i mbajnë orët shtesë për ato orë që janë humbur. Ndërsa është e vërtetë se personelin në Drejtorinë e Arsimit e kemi të vogël dhe kërkohet staf më shumë administrativ. Mirëpo ne e dimë që nuk varet prej komunës edhe numri i caktum i personelit, sepse ju edhe pse janë pak janë shumë të zot dhe besoj që po ja dalin që edhe punën e tyre me e kryer me vullnet. Mirëmbajtja sanitare: ne e kemi edhe kontratën me operatorin ekonomik, mirëpo për shkak të buxhetit në komunë... u dëgjua te shkolla e Gërmovës, po ka qenë një video. Ishemi atje në inspektim me thënë të drejtën, ajo video është hudhë poshtë, për arsye se shkolla na ka befasuar se sa ka qenë e pastër! Domethënë ajo video ka ra poshtë, edhe pse inventari është i dëmtuar, mirëpo është i përdorshëm, mundesh lirisht me shku me e vizitu, shkolla është në gjendje perfekte! Edhe pse thashë që inventar kemi të dëmtuar, po për momentin është i përdorshëm. Për printera: po ne si komunë e Vitisë kontratën e kemi me Centralin e Prokurimit Publik (AQP-në), mirëpo për tonerë ne e kemi kontratën tonë me operator ekonomik. Dhe çka është më se interesanti: AQP-ja i ka bërë vetëm për institucionet komunale, e jo për shkolla printerët, edhe nuk kemi mujtë me shpallë përmes prokurimit tender, se ata e kanë thanë që do të ketë për institucione, po jo për shkolla! Kështu që furnizohet vetëm komuna me printera, e për tonerë e kemi kontratën. Tabelat digjitale pse jo, edhe unë jam i pajtimit që të gjitha shkollat t'i kenë tabelat digjitale, mirëpo për shkak të buxhetit ne nuk kemi mundësi. Kërkesat e shumta që i kemi bërë në MASH, mirëpo edhe atje normal zvarriten e shkojnë me tenderë të ndryshëm. Shumë frikë ka kaluar edhe tenderi i inventarit atje, ku kemi bërë kërkesa që i kemi pasë vitin e kaluar, se këtë vit nuk na kanë marrë për bazë hiq! Shkollat e Pozharanit për mirëmbajtje nuk kam vërejtje; i kemi punëtorët teknikë, thuaj se në të gjitha shkollat punëtorët teknikë janë të zotë, por nganjëherë varet edhe prej materialit të higjienës sa kemi ne me ju ofru si DKA. Ndërsa sa i përket prindërve që po hyjnë në oborret e shkollave, është alarmante, jo vetëm në Pozharan, po thuaj se edhe në shkolla tjera. E nëse inspektorati i vendos shenjat, do të informohen organet kompetente dhe të mirren me këtë çështje. Jakup, objektet që kanë pikë vitin e kaluar: me të thënë të drejtën, shumica e shkollave që kanë pasur këtë problem kemi intervenuar, mirëpo mundet me ndodhë me piku tani për tani – nuk na pikë asnjë shkollë! Jemi munduar që të intervenojmë te të gjitha këto, edhe pse e patëm në një rast kur e patëm stuhinë në fshatin Skifteraj: shkollës komplet iu është dëmtuar kulmi, dhe aty kemi pasur më primare që ta rregullojmë atë objekt shkollor. Për dimër jemi përgatitur me kohë, i kemi marrë lëndët djegëse, kështu që thuaj se të gjitha shkollat janë të pajisura me dru, nuk e kemi problem. E te pikja e shkollës mundet me ndodhë që pikin, po e kemi operatorin dhe do të theksojmë të mundohemi që t'i evitojmë nëse ka dëmtime. Ekrem, te konkurset e rregullta, ta shpjegoj çështjen e listës së pritjes. Lista pritëse mund të bëhet në secilën lëndë, mund të jetë për edukim, mund të jetë për biologji, fizikë etj., etj. Problemin më të madh e kemi në fizikë, biologji, gjuhë gjermane, që kemi mungesë të kuadrove, dhe për këtë arsye do të përsëritet prapë konkursi. Kemi bërë listën pritëse për arsye që mos të kemi shumë shpesh konkurse të rregullta dhe t'i evitojmë konkurset e rregullta, e në momentin që hapet konkursi i rregullt, kjo listë bie poshtë. Mirëpo këtë listë zakonisht na e mbajmë për një vit, e mbajmë edhe për pushimet e lehonisë që ndodhë, se për exemplu janë një numër i madh i mësimdhënësve këtu që herë pas herë na duhet t'i zëvendësojmë, dhe jam munduar që me 1 shtator asnjë klasë të mos na mbetet pa mësimdhënëse dhe kemi

përjashtim të pushimeve të lehonisë, se ato nuk hyjnë në numër të mësimdhënësve të rregullt, aty kemi të drejtë. Ndërsa sa i përket që i kemi të rregullt, aty tani problemi na shfaqet kur të na lëshojnë orët, mirëpo na kemi pasë mundësi për arsye se kemi pasur mësimdhënës që kanë mujtë me marrë orë dhe e kanë bërë normën e plotë, dhe kështu nuk e kemi atë problem, se nëse e marrin gjysmë norme, nuk paguhen.

z.Ekrem Abazi: Besoj se rrallë mësimdhënëse, shumë rrallë, kërkon që me ju heq 10 orë. Po ju vetë ia jepni nga 10 orë, vetëm me u kyç aty, tani në të ardhme shumë shpejt me ja plotësu normën atij që e keni marrë ju për interesa tuaja, që i keni obligime ndaj tyre. Se e di si shkon kjo punë. A po thu, keta s'i gjen ti 5 mësimdhënësa që kërkojnë me pas normën jo të plotë? E di që ti mundesh me qenë viktimë e kësaj pune, se s'e kryen ti këtë punë, se nuk të lejojnë me kry ata vetë. Të dërgojnë emrat dhe nuk e keni çare pa i pranuar, se qashtu është rregulla, u bë rregull tek na dhe ju nuk mundeni me lëviz fare. Se krejt mësimdhënësit kërkojnë me pas orë të plota. Unë e pashë që për 4 orë po lujshin 150-200 euro, e pak ka asi që e kërkojnë gjysmë norme, po shumica janë që ju i merrni me gjysmë norme, që me i shti në sistem njerëzit e juaj që i keni obligim para zgjedhjeve. Se kurrë nuk kalon qajo që thave, është në listën e pritjes, ai nuk vjen në pyetje kurrë, se atë e keni lanë, edhe me qenë më i afërt, me përgatitje më të mëdha, ju vetëm me gjykatë se i merrni! Pa përgatitje shkollore ju kanë qitë në gjyq, keni raste. E me listën pritëse, ata që janë, ju jeni tu bë hajgare, se ata mendojnë që janë në listën pritëse. Në atë moment që kërkohet një mësimdhënës për qat lëndë, ai s'ia di farën, se atë s'e merr një hiq në start. E lini listën pritëse që mos me marrë kurrë, se nuk është personi që ju keni obligime ndaj tij, e nuk e merrni kurrë. Kjo çka bëhet në komunën tonë, te arsimi e te shëndetësia, është turp!

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: Ekrem, lista pritëse është publike. Në momentin që është publike, aty e din secili se kur i vjen rendi, kështu që unë nuk e anashkaloj asnjë që është në listën pritëse brenda vitit. Madje, thuajse të gjithë që kam pasur nevojë prej listës pritëse i kemi marrë deri në hapjen e konkursit të rregullt. E në momentin që merret mësimdhënësi, i nënshkruhet kontrata, dhe në momentin që i nënshkruhet kontrata, kam obligim që t'ia kompletoj orët. Pa marrë parasysh, unë orët ia kompletoj ashtu siç kërkohet në konkurs.

z.Ekrem Abazi: Ju ja kompletoni orët vetëm atyre që jeni të dirigjuar prej kryetarit, se absolutisht jo! Kjo punë bëhet vetëm për njerëzit që janë të afërt e ju që keni obligime ndaj tyre.

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: Ekrem, në konkursin e fundit është publik, është në web të komunës, mundesh me këqyr. Edhe në fund shkruan se ku i ka orët para se të merret mësimdhënësi, dhe aty gjithmonë janë orët ku i kanë dhe për sa orë kërkohet mësimdhënësi. Secili që ka të drejtën aplikon për ato orë që shpallen në konkurs përmes burimeve njerëzore.

z.Ekrem Abazi: Ka pa orë, ka! Pse me shpallë konkurs, kurse pa orë mundet me i plotësu ato orë një tjetër mësimdhënës? Ose shkoni prej Pozheranit e çoni në Buzovik, ose prej Skifteraj e çoni në Sllatinë, si shembull!

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: I nderuar, çështja e arsimit është më delikate dhe nuk mundemi mësimdhënësin e gjuhës shqipe me e çuar për matematikë!

z.Ekrem Abazi: Ka sa dush për të gjitha lëndët, vetëm për një konkurs! Kqyre sa konkurojnë, po disa nuk i merrni as në intervistë fare, se nuk janë militantë të partive. Këtë e bëjnë të gjitha partitë, edhe nuk janë me kushte të njëjta — lirisht me ta marrin lejen e LDK-së, se ka fitu LDK-ja. Po absolut, kushtet dallojnë, ata s'i merrni se nuk është në LDK.

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: Ka të drejtë secili qytetar përmes padisë me fitu vendin e punës.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Kjo pikë është veç informatë, nuk votohet, vazhdojmë me pikën tjetër.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratim propozim vendimin për vënien në shqyrtim publik Projekt Harten Zonale të Komunës së Vitisë 2026-2034

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: E dini që pas planit zhvillimor, për me u kompletu plani zhvillimor, duhet të kalohet edhe dokumenti i dytë: hartat zonale. Harta zonale e dini që është në punim e sipër gati që 1 vit me procedurat, puntorët që kanë vazhduar deri tani për ta dërguar në ministri. Dhe kalohet në procedurë

kur kuvendi ka për detyrë me e shpallë në diskutim publik. Diskutimi publik, pasi ta kthen ministria, do të jetë për 30 ditë. Gjatë 30 ditëve kemi mundësi ta diskutojmë planin me ekspertë, kompani, drejtori.

zn.Zyrafete Rama, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ky propozim-vendim është bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Vitisë, si dhe Rregulloren e Kuvendit Komunal. Drafti fillimisht i është dërguar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për mendim paraprak. Komuna, së bashku me kompaninë hartuese të hartës zonale, i ka kryer të gjitha korrigjimet dhe procedurat ligjore. Fatkeqësisht, ministria për një kohë të gjatë na ka mbajtur në pritje, dhe ne, në harmoni me ligjin dhe aktet normative, kemi vendosur t'i zbatojmë dispozitat ligjore lidhur me heshtjen administrative. Para vetes keni draftin e Hartës Zonale të Komunës së Vitisë 2026–2034, së bashku me të gjitha proceset administrative dhe ligjore të zhvilluara. Prandaj, ju ftoj që ta mbështesni këtë propozim-vendim!

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Unë edhe në KPF kërkova që, gjatë diskutimit që është për 30 ditë, ta kemi një takim vetëm me anëtarët e kuvendit, që të njoftohemi më mirë në detaje, e që kur të miratohet në kuvend me pasë njohuri më shumë.

z.Basri Aliu: Unë e përgëzoj drejtoreshën për iniciativën e marrë për me e sjellë në kuvend, se edhe ashtu kërkesat janë që sa më shpejt të kryhen edhe këto hartat zonale, në mënyrë që të fillohet të punohet edhe ligjërisht në ndërtim në Komunë të Vitisë. Andaj, unë e përkrah këtë iniciativë.

z.Visar Demiri: Plani zhvillimor dhe hartat zonale janë dokumentet më të rëndësishme të planifikimit të Komunës së Vitisë, dhe si dokumente shumë të rëndësishme i japin kahje zhvillimit të komunës së Vitisë. Shqyrtimi publik i jep mundësi qytetarëve që të bëhen pjesë e hartimit të hartave zonale dhe t'i mbrojnë interesat e tyre gjatë këtij procesi. E përgëzoj drejtorin dhe kompaninë që kanë bërë punë, veç dokumenti ka ardhur gati në fund, dhe si dokument e përkrah.

z.Jakup Demiri: E rëndësishme është që me u ditë: ne prej sotit, kur mundemi me mbajtë këtë takim me kompaninë dhe subjektet politike? Po them ashtu, se ne kemi mundësi që të marrim edhe ndonjë njeri që është profesionist me vete në takim. Ne e dimë që harta zonale buron nga Plani Zhvillimor Komunal dhe nuk ka mundësi me i ikë asaj që nuk është në plan, dhe nga ajo duhet të rrjedhë kjo. Ne, si grup, e mbështesim këtë dhe presim që të bëhet më e mira e mundshme.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Jakup, duhet me na e kthy ministria që ne duhet me e qitë në diskutim publik. Varet sa na vonon ministria, se e ka këtë afatin 30 ditë, dhe për këtë nuk mundemi me caktu [datën], por në momentin që na kthen ministria, ne e caktojmë një ditë. Pasi që nuk ka më për diskutime, kërkoj për votim: pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, [dhe] asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pike.

Si pikë e tetë e rendit të ditës:

8. Pyetje dhe përgjigjje

z.Jakup Demiri: Pyetje për nënkryetarin: Te problemi i ujit të pijes në Komunë të Vitisë: të shtunën më ka dërguar një qytetar prej Trestenikut një video të ujit të pijshëm që është krejt i turbullt. Ku e keni gjendjen e ujit të pijes në ujësjellësin e Komunës së Vitisë? Në disa trotuare që kanë qenë të papërfunduara ka një kohë të gjatë, por në disa trotuare a do të përfundojnë, se nuk ka shumë punë, por me i përfundu do të ishte mirë? Dhe pyetja tjetër ka të bëjë me këto mbeturina që po i qesin qytetarët: Drejtoria e Inspektoriati çka ka vepruar, se territori i komunës sonë është alarmant me mbeturina nëpër fusha e ledina, është e tmerrshme! E di që është problem me e menaxhu, por a ka gjoba të shqiptuara?

z.Nuhi Ramadani: Kam dy kërkesa. Njëra prej "Sokolëve" dhe "Kecëve": ata kërkojnë që në hyrje prej Goshicës dhe daljes prej Verbanit, nga Goshica në udhëkryq, të vendosen dy pengesa në distancë 30 metra njëra prej tjetrës. Arsyeja është që në atë udhëkryq po lëvizin veturat me shpejtësi marramendëse. Dhe kërkesa tjetër, që e kam bërë edhe më herët: kanalizimi është nxënë që 5 muaj. Kërkoj që me e kontaktu kompaninë që është marrë me atë punë, sepse ka marrë sipërfaqe të madhe të tokës dhe e ka dëmtuar.

znj.Elsa Jahija: Furnizimi me ujë të pijshëm mbetet nga nevojat më urgjente të qytetarëve të Vitisë. Për shumë familje kjo është një çështje e përditshme, prandaj kërkon vëmendje dhe investime të vazhdueshme nga komuna. Duke parë investimet e viteve të fundit, konsideroj se nuk është bërë mjaftueshëm për t'i dhënë

zgjidhje këtij problemi. I nderuari nënkryetar, së fundmi është bërë e ditur se Komuna e Vitisë është përfshirë në një projekt të Bankës Botërore për rritje të kapaciteteve të furnizimit me ujë të pijshëm, përfshirë ndërtimin e një impianti të ri për trajtimin e ujit në Letnicë. A mund të na jepni një përgjigje konkrete: në cilën fazë ndodhet aktualisht ky projekt, cilat janë hapat e radhës dhe kur pritet të kemi një afat konkret për fillimin e realizimit të tij? Qytetarët e Vitisë kanë nevojë të dinë se kur ky projekt nise të japë rezultate në furnizimin e tyre me ujë të pijshëm.

z.Elham Emërllahu: Një problematikë që dua ta ngris këtu i drejtohet Drejtorisë së Mirëqenies Sociale. Të gjithë jemi dëshmitarë që javët e kaluara ose muajt e kaluar ka pasur disa raste të sulmeve fizike ndaj stafit shëndetësor, të mjekëve dhe infermierëve, në Komunën e Vitisë. Edhe unë personalisht, bashkë me Sindikatën e Shëndetësisë në protestën e fundit që ata e kanë organizuar, i jam bashkangjitur. Edhe bazë të bisedave, por edhe të kontakteve që kemi pasur me ta, ata kanë shprehur shqetësim se nuk ka siguri të mjaftueshme në ushtrimin e detyrës të cilën e kanë, dhe nuk e di çfarë ka paraparë komuna dhe drejtoria. Por ata i kanë disa kërkesa, kanë qenë edhe publike; njëra prej tyre ka qenë sigurimi fizik në objektin e QKMF-së në Viti dhe Pozheran, për faktin se nuk ka qenë pasqyrë e mirë që Komuna e Vitisë me u bë lajm për sulme fizike ndaj stafit shëndetësor, dhe nuk e di çfarë hapa janë ndërmarrë. Pyetjen tjetër që dua ta përsëris, që e kam bërë edhe në muajin prill për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, janë pyetjet e njëjta, vetëm se përgjigja e tij ka qenë "çështje javë apo dite që kanë me fillu punimet". Është fjala për stadiumin e qytetit në Viti dhe për stadiumin e Vllaznisë së Pozheranit, për tribunat edhe për nevojat e tjera të cilat i kanë ata. Domethënë, kanë kaluar disa muaj dhe unë nuk kam informata dhe nuk kam parë që është bërë diçka për stadiumin e qytetit të Vitisë apo për stadiumin e Vllaznisë së Pozheranit. Në aspektin e sportit, Komuna e Vitisë ka qenë jashtëzakonisht e afirmuar, ka disa sportistë individualë që kanë arritur edhe gara ndërkombëtare, botërore, tituj – siç është rasti i kickboxeres nga Vitia. Po klubet futbollistike dhe klubet e tjera janë duke pasur vështirësi të mëdha, andaj kisha kërkuar prej drejtorit me na sqaru çka është puna tash.

zn.Mirjeta Hamiti: Përshëndetje për të gjithë! Pasi që e pamë te projektet investive publike është si pikë edhe ndërtimi i trotuareve dhe rivitalizimi i tyre, dua ta di: a kanë me u trajtuar me prioritet kërkesat që kemi bërë për rregullimin e trotuarit te shkolla në Dobresh, duke e pasur parasysh që është shkolla me rritje të numrit të nxënësve?

zn.Liridona Bislimi: I nderuar nënkryetar, te mbledhja e KPF-së e kam ngritur një çështje për diskutim, e cila ka të bëjë me kërkesën e banorëve të fshatit Dobresh për rregullimin e ndriçimit publik te fusha e vrapimit. Domethënë, ta kam shpjeguar interesin që e kanë për këtë pjesë, sepse është duke u shfrytëzuar shumë, dhe jo vetëm nga banorët e fshatit Dobresh, por edhe të vendeve përreth. Andaj, dua një sqarim: a keni diskutuar ose shqyrtuar si mundësi që me u bë realizimi i kësaj kërkese? Dhe çështja tjetër: për shkollën në Dobresh – është një ndër lokalitetet ku ka rritje të madhe të regjistrimit të nxënësve, dhe dua të koncentrohem më shumë tek pjesa e çerdhes publike. Prej takimeve që kemi pasur me prindërit, ka qenë kërkesë specifike e tyre për me pasur një kënd të lojrave, për shkak se e dimë që në një çerdhe pjesë e aktiviteteve të fëmijëve është edhe pjesa e lojrave të cilat ata duan me i shfrytëzuar. Andaj, drejtoreshë, dua ta di: a e keni analizuar këtë çështje, a e keni menduar me e pasur si planifikim të buxhetit për aktivitetet e viteve në vazhdim? Edhe një kërkesë që ka qenë e vazhdueshme dhe temë diskutimi nga studentët natyrisht që janë bursat: ka kaluar viti akademik, drejtoreshë, nuk e di se kur keni me bë shpërndarjen e bursave. Ka dalë lista e emrave që janë pranuar, por shpërndarjen e mjeteve nuk e keni bërë, andaj edhe këtu dua përgjigje se kur ka me u bë ndarja e mjeteve.

z.Basri Aliu: Një kërkesë te Drejtoria e Kulturës dhe Sportit: duke e ditur gjendjen e arkivës së komunës, se në çfarë gjendje është, kisha dashur që iniciativa e një projekti të merret pak më seriozisht, jo vetëm ti por gjithë qeveria komunale, në mënyrë që arkiva dhe dokumentacionet të cilat janë – edhe të pakta që kanë mbetur – të kthehen në gjendje më të mirë, në mënyrë që t'i shfrytëzojnë qytetarët e Komunës së Vitisë. Sepse në podrum atje, sa e di, është një gjendje e rëndë, andaj kisha dashur ta merrni parasysh këtë. Dhe lidhur me rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës, po e bëj si pyetje për arsye se kam pasur disa kërkesa prej zyrtarëve komunalë që ta parashtroj: pasi që herën e kaluar nuk kaloj statutit [statuti], atëherë ku ka mbetur kjo çështje dhe a do të presim që të delë para kuvendit?

z.Ilir Zuka: Kam një pyetje dhe një falënderim për nënkryetarin: në mbledhjen e fundit të KPF-së e kemi ngritur një shqetësim – trotuari te shkollat e mesme në Pozheran u bllokohej prej veturave, dhe falë intervenimit të shpejtë është liruar trotuari, pasi që është në kujdes gjatë orëve të shkollës, janë në mbikëqyrje edhe nga policia, gjë që është bërë punë e mirë. Dhe mundësisht, vijat për këmbësorë me u shënuar, se janë fshirë të gjitha dhe është rrezik për fëmijë.

z.Ekrem Abazi: A keni bërë përpjekje këtu, nënkryetar dhe drejtori përgjegjëse, për me gjetë një hapësirë për ndërtimin e banesave sociale? Kanë përfituar 21 komuna, ka komunë që ka fituar 4.4 milionë euro. Ju a keni bërë të paktën një përpjekje me gjetë një hapësirë me i ndërtu ato banesa? Dhe pyetja tjetër, për shëndetësinë: isha një ditë te analizat, te hyrja aty në katin e parë, ishte e pambuluar një pjesë, vetëm dritarja natën [ose pjesa e hapur] dhe aty fasada kish ra, dhe ajo pjesë ish bë sikur me qenë kotec i pulave! Me një investim shumë të vogël – bile një mjek tha mundemi me bë depo të barnave, por edhe mos me bë depo, ish turp me pa se në çfarë gjendje ishte. Një fotografi e kam, mundesh me e pa, drejtor.

z.Faruk Shabani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kam dy çështje për fshatin Ramnisht: pyetja e parë është që ndriçimi mungon qe një muaj Viti–Ramnisht; dhe pika tjetër, kërkesë prej fshatit të bëhen pengesa në rrugë, për shkak se në udhëkryqin Ramnisht–Viti–Mogillë–Beguncë kemi problem gjithmonë me aksidente, e rastet e fundit i kemi pasur edhe me fatalitet. Kërkojmë nga organet kompetente të marrin masa konkrete, të bëhen pengesa në rrugë, që të mos kemi telashe me fëmijë, sepse aty kalohet për me shkuar në shkollë. Edhe pse e dimë që ministria e ka për rregullimin e kësaj, mirëpo ne duhet me bë kërkesën që të kemi polic të shtrirë në rrugë. Këtë e kërkojmë se në fshatin Verbovc në të njëjtën rrugë ka pengesa, ndërsa në fshatin tonë nuk është pranuar.

z.Halil Musliu, drejtor: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ju e dini që kanë qenë dy sulme në shtëpinë e shëndetit ndaj stafit mjekësor; kanë qenë të paprovokuara dhe të paimotuara nga stafi dhe puna e tyre. Domethënë, është e pamundur ne me i ndalu elementët kriminalë në një mënyrë derisa nuk ka asnjë element që atakon, që më provokon, kanë ndodh si kanë ndodh. Unë kam mbajtur takim me menaxhmentin e QKMF-së, por edhe me stacionin policor për ndërmarrjen e masave, gjithashtu dhe jemi në procedurë rreth çështjes së ofrimit të sigurisë për punonjësit shëndetësorë. Nuk është problemi numër një aty për arsye se te sulmi i parë ka qenë policia në vend të ngjarjes edhe ka ndodh sulmi; ndonjëherë është e pamundur elementët kriminalë me i ndalu pavarësisht çfarë sigurimi ke. Edhe jemi marrë vesh që në të ardhmen të ndërmarrim masa, të sigurojmë kushte të sigurisë, por ju e dini që në kodin buxhetor nuk lejohet që të ketë punëtorë që paguhen [në këtë formë], por po e shqyrtojmë mundësinë e kontraktimit të shërbimeve. Por nga ajo që kemi llogaritur, minimum duhen 7–8 punëtorë, për shkak se i kemi dy qendra të mjekësisë të cilat punojnë 24 orë, dhe gjendja financiare që kemi nuk na lejon një komoditet të tillë. Në momentin që krijohen mundësitë e para që të stabilizohemi financiarisht, ju e dini që kriza financiare që është shkaktu veç, domethënë e kemi në agjendë – po besoj që muajve në vijim do të zgjidhet kjo çështje. Te kjo te analizat që u tha, është fakt, se e kam vërejtur edhe unë, i kam vizituar të gjitha qendrat e ambulancave dhe jo vetëm një herë, për shkak se kemi pasur edhe stuhinë që ka shkaktuar dëme dhe kemi bërë një incizim të gjendjes. Kemi një 7–8 vende ku duhet me intervenu, por kemi vetëm 60 mijë euro për investime: 30 mijë jemi shtrënguar me i bë furnizimi me pajisje medicinale, 30 mijë na kanë mbetur për renovim. Ne tash kemi bërë një listë prioritare, p.sh.: aty ku është pamundësuar zhvillimi i punës normale kemi intervenuar; në Goshicë, Remnik kemi intervenuar kulmin edhe kemi bërë rregullimin. Mundësitë financiare kaq i kemi, prioritetet i kemi bërë.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Po, ju përgjigjem Elhamit rreth stadiumit të qytetit dhe tribunave në Pozheran. Për njoftim, Elham: te stadiumi i qytetit veç kemi filluar punët, ka filluar gërryerja e bazës së stadiumit të qytetit. Normalisht që punët, për shkak të mungesës së kapaciteteve buxhetore, janë duke na shkuar shumë më ngadalë sesa kemi dëshirë, por tash më kemi një memorandum me Federatën e Kosovës: pjesën e bazës e kemi me e kry komuna, jemi në proces e sipër, punët veçse kanë filluar, kurse pjesën tjetër, tapetin dhe zhveshtoren, e ka marrë përsipër me e kry Federata e Futbollit të Kosovës, dhe urojmë që të përfundohet sa më shpejt. Rreth tribunave të stadiumit të Pozheranit: menjëherë në seancën tjetër ne kemi marrë një vendim për rialokimin e mjeteve në shumë prej 40 mijë eurosh për projektin e tribunave të stadiumit "Ibrahim Kurteshi" në Pozheran.

Fatkeqësisht, edhe në këtë projekt na kanë ndërhyrë përmbaruesit, të cilët kanë ndërhyrë në secilin projekt në Komunën e Vitisë, por jemi në proces dhe në koordinim edhe me Ministrinë e Sportit. Dje është dorëzuar në Ministrinë e Sportit, bile kemi punuar së bashku me inxhinierët, e kemi dorëzuar në Ministrinë e Sportit bashkë me të gjithë projektin detal dhe kemi marrë zotimet se do të futet në planifikimin buxhetor të Ministrisë së Sportit dhe Rinisë për vitin 2027 si një nga projektet më të rëndësishme për Komunën e Vitisë, por në veçanti për stadiumin e Pozheranit. Ndërsa, për arkivën e qytetit: e para, pajtohem me konstatimin dhe shqetësimin, sepse në vazhdimësi jam munduar, edhe konstatimet reale kam dëshirë me i marrë, sepse veç kështu ne mundemi me e ndryshuar gjendjen; duke i pranuar gabimet e sfidat, mundemi me e ndryshuar gjendjen reale. Brenda autorizimeve dhe kapaciteteve tona, një hapësirë lart te Shtëpia e Kulturës, për një material të ndjeshëm, e kemi lëshuar edhe kemi vendosur një material të ndjeshëm të arkivës. Por këtu është një problem: qeveria e Republikës, parlamenti, vitin e kaluar e ka implementuar ligjin e ri shtetëror për arkivat, ku sipas ligjit të ri komunat nuk lejohen të kenë tamam arkiv shtetëror, por bëhen arkivat rajonale. Domethënë, një pjesë e madhe që gjendet në arkivin komunal të Vitisë do të kalojë në arkivin rajonal që është në ndërtim e sipër në Gjilan – një vendim që për mua ka qenë i papranueshëm, sepse qytetarit ia largon shërbimet. Por megjithatë, ky është vendimi edhe ne duhet me e implementuar. Në këtë kontest kemi pasur edhe neglizhencë, sepse bashkë me Arkivin Qendror të Kosovës kemi edhe një marrëveshje ku kemi me filluar digjitalizimin e arkivit komunal. Por pajtohem me krejt shqetësimet e tua dhe do të mundemi që brenda mundësive me intervenuar në atë pjesë që është shumë sfiduese.

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: E nderuara znj. Liridona, për fshatin Dobresh që e kemi çerdhen afër shkollës, për një kënd të lojrave, me thënë të drejtën në planifikim e kam futur te e domosdoshmja, por jo gjithçka që është e nevojshme; për shkak të buxhetit nuk kam mundur ta planifikoj. Mirëpo, kemi fituar një projekt përmes ministrisë, me një organizatë italiane, kemi fituar trajnimin e edukatoreve dhe një kënd të lojrave, dhe do ta kem parasysh nëse më jepet mundësia, pse jo, edhe në fshatin Dobresh. Ndersa, për bursat: këtë vit kanë përfituar 152 studentë; për shkak të kufizimeve buxhetore kryetari nuk ka mundur ta rrisë numrin e përfituesve, prandaj komisioni ka proceduar me kriteret e parapara me rregulloren. Sipas informacioneve që kam, tash kanë përfunduar edhe procedurat ankimore dhe jemi në fazën e përgatitjes së listave për financa, ku besoj që shumë shpejt do t'u dalin mjetet.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Jakup, për çështjen e ujit të Trestenikut e kemi lidhur kontratën, kam pasur edhe takimin e fundit, të cilët janë në pritje të pompave, dhe po besoj që problemi dalëngadalë do të zgjidhet një herë e përgjithmonë, ku do të kalojnë në menaxhim të "Hidromoravës" që tani, dhe Instituti për Shëndetin Publik bën kontrollimin e tyre. Tash e di që momentalisht është uji i pakontrolluar, edhe pse ju shkon te shpia. Çështjen e mbeturinave do ta shtroj te drejtori që nuk është këtu; megjithatë, e pashë një pengesë ligjore, domethënë ka dalë një pengesë që tash, derisa kanë pasur të drejtë inspektorët në dënime, tash kish ardhur që ato dënime në aspekt administrativ, sipas ndryshimit të një ligji, duhet sipas gjykatës, dhe unë besoj që kish me na mbushur me bërllok hala më shumë. Pengesat në rrugë: e ke inspektorin e komunikacionit, shkon e bën kërkesën, del në vend të ngjarjes dhe besoj që ato çështje kalojnë. Elsa, është e vërtetë që është fituar projekti, kontratën, kam pasur takim me ta, kanë qenë në Viti, kam biseduar edhe me mbikëqyrësin edhe me kryerësin: sipas të gjitha gjasave ka dalë një pengesë se disa rrugë të cilat i kanë lënë kanë dalë jashtë asaj sipërfaqeje që i kemi shpronësuar ne këtu, dhe tash janë në modifikim të projektit, por shpresoj që së shpejti duhet me ia nisur. Ndërtimi i trotuareve, e përmendi Jakupi dhe të tjerë. Me të gjithë ata të cilët kemi pasur kontratë i kemi thirrur në zyrë, kemi biseduar dhe kemi shtruar presion me dalë. Unë besoj që kanë me ia filluar, ashtu janë zotu, shumë po frigohem se a kemi me mundur me iu nejtë prapa, gati se ashtu është gjendja; kjo pengesë kështu vlen edhe për Dobresh. Liridona, pas bisedës që kemi pasur në KPF, kam shkuar të njëjtën ditë, e kam shqyrtuar: aty janë të parapara edhe dritat edhe shumë objekte tjera përcjellëse, por këto mungesa e parave që po na e merrni, nuk po them që me ta qitë ty, por urdhnoni, merreni ndikimin në qendër i përfundojmë disa objekte që janë të rëndësisë së veçantë, në këtë rast edhe të palestrës edhe të objekteve përcjellëse që do të ketë ndriçim, se aty është bërë një kompleks i mirë që shfrytëzohet nga gjithë qytetarët. Rregulloren, Basri, e kam diskutuar me kryetarin, me komisionin, e kanë në përfundim, ndoshta mbledhjen e

ardhshme e bijnë. Ilir, atë çështje që kam mundur me e kry, e kam kryer; atë tjetrën e kam shtruar me dalë me caktuar vijat ku janë për këmbësorë, që me ia lehtësuar edhe policisë kur e ushtrojnë detyrën e vet, ta shohim se çështje e tenderit, mos janë harxhuar mjetet, ta shohim çka mundemi me bë. Ekrem, përpjekje jemi duke bërë për atë çështje. Faruk, ndriçimin publik mundem me e shtru, dhe kam pasur disa qytetarë që ma kanë shtruar formën e pengesave; e vetmja formë që mendoj që mundet me shku është me frekuentuar zyrën e inspektorit, dhe inspektori me iu drejtuar ministrisë përkatëse të cilën e administron atë rrugë. Domethënë, me një kërkesë nga këshilli i fshatit i drejtohesh inspektorit, inspektori ju drejtohet; nëse e ka koordinimin në vijë me ministrinë përkatëse, besoj që bëhet zgjidhja.

z.Ekrem Abazi: Unë këtë punë të ministrisë s'po e di çka është kjo; ndoshta është që 2–3 muaj keni pasur veç me apliku, komunat tjera nuk kanë çuar "msit" hiç, veç kanë aplikuar dhe kanë fituar. Ne shpeshherë e thojmë "Komuna ime, shtëpia ime", por jo me pas qenë për interesa tona personale, se unë dhe ju bashkë nuk kishim lanë gur pa rrotulluar pa fituar, nuk e kishim lanë! Por ka qenë për qytetarë që kanë qenë pa strehë dhe nuk na ka interesuar fare; ata i dujmë veç kur na vijnë për vota! Kjo është totalisht e papranueshme për mua. Kanë përfituar komuna që janë shumë më të pasura se na dhe kanë fituar.

zn.Liridona Bislimi: Nënkryetar, pata tri çështje që i përmenda: domethënë, te ndriçimi publik te fusha e vrapimit në Dobresh, bursat për studentë dhe këndi i lojrave. E kemi pasur përmendur me kolegun Ilir që e ceku çështjen e dëgjimeve buxhetore që po i mbani, dhe që kemi pasur kërkuar që me u stagnu kjo farë pune. Një ndër çështjet që lidhen me këto janë tri kërkesa; unë besoj që nëse e kishe mbajtë takimin prej momentit kur është bërë kjo fushë sportive – nëse kishe mbajtë takimin me banorët e fshatit Dobresh dhe atë rrethinë – një ndër kërkesat kryesore kishte me qenë kjo. Çerdhja në Dobresh është finalizuar, por në momentin kur është finalizuar është dashur me u mendu këndi i lojrave, se e ka rëndësinë e vet të veçantë. Tash unë po e përgëzoj drejtoreshën për këtë mundësi që paska, mirëpo kërkesat e banorëve janë të tilla. Për këtë dua me u ndërlidhur për dëgjimet publike që po i mbani, të cilat në fund të fundit nuk po e kanë asnjë efekt të vetëm, për shkak se kërkesat po janë shumë të dukshme dhe po janë të përsëritshme dhe të vazhdueshme. Fushën sportive e ke ndërtuar që një kohë shumë të gjatë në Dobresh, e katër herë është qe e përsëris këtë kërkesë: tash prap ke me mbajtë dëgjime publike, prap ki me marrë këtë kërkesë dhe nuk ka me u realizuar! Përderisa kontrata kolektive ekziston nëpër komuna tjera, pse ne po jemi e vetmja komunë që po i kemi këto problematika? Që, ku e ke Gjilanin: prej 17 marsit e ke shpallur konkursin, [e te ne akoma] nuk i ke shpërndarë mjetet.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Po dallojnë ndryshimet, se në komunën tonë po jepen nga 4 euro për kokë banori, e në Gjilan po shkon ndryshe.

z.Jakup Demiri: Nënkryetar, kur erdhëm prej pauzës, disa punëtorë që pastrojshin te parku thanë: "Folni në kuvend se pagat qe 3 muaj nuk i kanë marrë". Kjo është për mua më e rënda, kur këta njerëz nuk marrin paga! Ne më mirë është mos me dalë në Viti, kur e dimë se çfarë gjendje e kanë ata.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka më për debat, me kaq e përfundoj këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00 min

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Numri Protokollor Data			12-10-2026
Nr. Lëndës / Org. Njës.	Numri Prot.	Shënime / Klasifikim	Vlera Verifikuar
02-	402	07-1	132

Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-shtator 2026

Viti 12.10.2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA

DREJTORIA E FINANCAVE

Data/Datum/Date	12.10.2026
Nr/Br.	
Për/Za/To	Kuvendin e Komunës,Komitetin për Politikë dhe Financa
Përmes/Preko/Through	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From	Milihate Ajeti Drejtor i Drejtoris për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim
Lënda/Predmet/Subject	Pasqyrat Financiare për periudhën janar-shtator 2026

Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë paraqesim pasqyrat financiare të organizatës sonë buxhetore (657) për periudhen janar-shtator 2026 përfshirë të hyrat vetanake të realizuara si dhe shpenzimet buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike.

Të hyrat

Gjatë periudhës janar – shtator 2026 janë inkasuar gjithesej të hyra vetanake në vlere prej 1.115.746,64€, shkalla e inkasimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor është 86,18%, ndërsa Krahasuar me të hyrat për periudhën janar – shtator te vitit 2025 te hyrat e vitit 2026 jane me te ulta per 60.797,68€

Shpenzimet Buxhetore

Buxheti i Alokuar për periudhen janar – shtator te vitit 2026 nga fondet burimore: Granti qeveritar, të hyrat vetanake, dhe donacionet jane: 16.760.026,88€, ndersa shpenzimet jane: 16.255.876,45€ , shkalla e ekzekutimit te buxhetit per periudhen janar- shtator 2026 eshte 96,99% në krahasim me Alokimet për të gjitha programet dhe kategorit ekonomike.

Në vazhdim të këtyre pasqyrave në mënyrë tabelare do ti paraqesim shpenzimet buxhetore, duke i specifikuar sipas burimeve te financimit, programeve dhe kategorive Ekonomike.

Buxheti i Aprovuar,Alokuar dhe i shpenzuar per te Gjitha programet buxhetore - janar-shtator 2026

	Aprovim Kateg.&Ekonomike	Aprovime 10	Aprovime 21	Aprovimet 22	Aprovimet Donacionet	Totali i Aprovimeve
1	Pagat &Shtesat	10,870,225.00	0.00	0.00	5,280.18	10,875,505.18
2	Mall.&Sherbime	2,749,828.00	329,091.00	559.28	15,985.56	3,095,463.84
3	Komunali	290,000.00	0.00	0.00	0.00	290,000.00
4	Subvencione	500,000.00	220,000.00	1,230.00	8,309.42	729,539.42
5	Kapitale	2,619,502.00	745,569.00	302,066.47	134,505.69	3,801,643.16
		17,029,555.00	1,294,660.00	303,855.75	164,080.85	18,792,151.60

	Alokimet Kateg.&Ekonomike	Alokimet 10	Alokimet 21	Alokimet22	Alokimet Donacionet	Totali i Alokimeve
1	Pagat &Shtesat	9,134,956.43	0.00	0.00	5,280.18	9,140,236.61
2	Mall.&Sherbime	2,728,857.46	311,091.00	559.28	15,985.56	3,056,493.30
3	Komunali	289,000.00	0.00	0.00	0.00	289,000.00
4	Subvencione	498,700.00	77,000.00	1,230.00	8,309.42	585,239.42
5	Kapitale	2,619,502.00	632,983.39	302,066.47	134,505.69	3,689,057.55
		15,271,015.89	1,021,074.39	303,855.75	164,080.85	16,760,026.88

	Te paalokuara Kateg.&Ekonomike	Alokimet 10	Alokimet 21	Alokimet22	Alokimet Donacionet	Totali i Alokimeve
1	Pagat &Shtesat	1,735,268.57	0.00	0.00	0.00	1,735,268.57
2	Mall.&Sherbime	20,970.54	18,000.00	0.00	0.00	38,970.54
3	Komunali	1,000.00	0.00	0.00	0.00	1,000.00
4	Subvencione	1,300.00	143,000.00	0.00	0.00	144,300.00
5	Kapitale	0.00	112,585.61	0.00	0.00	112,585.61
		1,758,539.11	273,585.61	0.00	0.00	2,032,124.72

	Shpenzimet Kateg.&Ekonomike	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve	% shpenzimit
1	Pagat &Shtesat	9,134,956.43	0.00	0.00	4,220.00	9,139,176.43	99.99%
2	Mall.&Sherbime	2,604,387.91	293,153.60	0.00	7,695.18	2,905,236.69	95.05%
3	Komunali	262,527.63	0.00	0.00	0.00	262,527.63	90.84%
4	Subvencione	312,297.49	68,030.00	0.00	2,568.00	382,895.49	65.43%
5	Kapitale	2,529,770.05	605,840.11	295,941.67	134,488.38	3,566,040.21	96.67%
		14,843,939.51	967,023.71	295,941.67	148,971.56	16,255,876.45	96.99%

	Diferenca Alokim-Shpenzim Kateg.&Ekonomike	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve
1	Pagat &Shtesat	0.00	0.00	0.00	1,060.18	1,060.18
2	Mall.&Sherbime	124,469.55	17,937.40	559.28	8,290.38	151,256.61
3	Komunali	26,472.37	0.00	0.00	0.00	26,472.37
4	Subvencione	186,402.51	8,970.00	1,230.00	5,741.42	202,343.93
5	Kapitale	89,731.95	27,143.28	6,124.80	17.31	123,017.34
		427,076.38	54,050.68	7,914.08	15,109.29	504,150.43

	Diferenca Aprovim-Shpenzim Kateg.&Ekonomike	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve
1	Pagat &Shtesat	1,735,268.57	0.00	0.00	1,060.18	1,736,328.75
2	Mall.&Sherbime	145,440.09	35,937.40	559.28	8,290.38	190,227.15
3	Komunali	27,472.37	0.00	0.00	0.00	27,472.37
4	Subvencione	187,702.51	151,970.00	1,230.00	5,741.42	346,643.93
5	Kapitale	89,731.95	139,728.89	6,124.80	17.31	235,602.95
		2,185,615.49	327,636.29	7,914.08	15,109.29	2,536,275.15

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit për të gjitha njësit buxhetore

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	10,875,505.18	9,140,236.61	9,139,176.43	1,736,328.75	1,060.18	99.99%
2	Mallra dhe sherbime	3,095,463.84	3,056,493.30	2,905,236.69	190,227.15	151,256.61	95.05%
3	Subvencione	729,539.42	585,239.42	382,895.49	346,643.93	202,343.93	65.43%
4	Komunali	290,000.00	289,000.00	262,527.63	27,472.37	26,472.37	90.84%
5	Shpenzime kapitale	3,801,643.16	3,689,057.55	3,566,040.21	235,602.95	123,017.34	96.67%
	Gjithesejt	**18,792,151.60 €**	**16,760,026.88 €**	**16,255,876.45 €**	**2,536,275.15 €**	**504,150.43 €**	**96.99%**

Shpenzimet për të gjitha njësit buxhetore

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11111	Paga neto	6,428,574.93
11121	Tatimi në te ardhurat personale	529,607.40
11131	Kontributi pensional - punëtorit	434,793.05
11151	Sindikata	26,342.01
11152	Odat Profesionale	6,295.78
11211	Pervoja e punes	510,295.26
11311	Kontributi pensional - punëdhënsit	434,793.05
11411	Shtesa e veçant per te zgjedhurit	15,894.29
11413	Shtesat e performances	672,516.19
11418	Shtesat per nenpunesit e sistemit shendetesor	8,321.11
11431	Kujdestaria puna gjate nates dhe puna jashte orarit te punes	71,138.90
11611	Shtesat tranzitore	604.46
	Totali i pagave	**9,139,176.43**
13130	Transporti per udhetime zyrtare brenda vendit	14,743.68
13132	Akomodimi per udhetime zyrtare brenda vendit	580.00
13140	Transporti per udhetime zyrtare jashte vendit	16,693.63
13141	Para xhepi/meditje per udhetime zyrtare jashte vendit	1,106.00
13142	Akomodimi per udhetime zyrtare jashte vendit	379.87
13210	Energjia elektrike	208,754.89
13220	Sherbimet e ujesjellsit dhe kanalizimit	16,633.47
13230	Mbeturinat	21,577.83
13250	Telefonia Fikse	5,561.44
13260	Pagesat - vendime gjyqesore	10,000.00
13310	Interneti	2,246.40
13320	Telefonia Mobile	14,052.53
13430	Sherbime te ndryshme shendetesore	483,265.33
13440	Sherbimet keshilldhenese dhe profesionale	839,379.59

13445	Sherbimet e veqanta - konsulente dhe kontraktor individual	8,142.22
13450	Sherbimet e shtypjes / printimit	48,730.94
13460	Sherbime kontraktuese tjera	34,513.36
13470	Sherbimet teknike	5,240.00
13480	Shpenzimet e anetaresimit	7,048.05
13503	Kompjuteret	4,772.00
13508	Pajisjet e trafikut	34,988.70
13509	Pajisje tjera	49,035.50
13610	Furnizimet per zyre	51,684.91
13611	Furnizimi me dokumenta bllanko	2,040.00
13620	Furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	29,684.04
13630	Furnizimet mjekesore	50,737.09
13640	Furnizimet e pastrimit	7,192.30
13760	Drute dhe prodhimet e drurit per ngrohje	121,119.30
13780	Derivatet per automjete, gjenerator dhe makineri	50,832.25
13950	Regjistrimi i automjeteve	1,500.00
13951	Sigurimi i automjeteve	3,402.39
13954	Kontrollimi teknik i automjeteve	320.00
14010	Mirembatja dhe riparimi i automjeteve	26,136.00
14022	Mirembatja e ndertesave administrative dhe afariste	183,115.68
14023	Mirembatja e ndertesave arsimore	9,958.76
14032	Mirembatja e rrugeve lokale	267,716.42
14040	Mirembatja e teknologjis informative dhe te komunikimit	3,532.50
14050	Mirembatja e mobiljeve dhe paisjeve	78,519.80
14060	Mirembatja rutinore	46,846.00
14220	Botimet e publikimeve	1,020.00
14230	Shpenzimet per informim publik	5,199.52
14310	Kompensimi i perfaqesimit brenda vendit	36,437.11
14410	vendimet gjyqesore	363,324.82
	Totali për shërbimeve mallra dhe komunali	**3,167,764.32**
200	Subvencionet dhe transfere	276,895.49
22300	vendimet gjyqesore	106,000.00
	Totali i subvencioneve	**382,895.49**
300	Investime kapitale	1,994,816.86
34000	Pagesat sipas vendimeve gjyqesore	1,571,223.35
	Tatali i investimeve kapitale	**3,566,040.21**
	Gjithsej shpenzimet	**16,255,876.45 €**

Zyra e Kryetarit
Kodi 16033

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	418,000.00	338,283.06	338,283.06	79,716.94	0.00	100.00%
2	Mallra dhe sherbime	150,562.58	150,562.58	136,475.44	14,087.14	14,087.14	90.64%
3	Subvencione	171,230.00	136,230.00	133,800.00	37,430.00	2,430.00	98.22%
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	**739,792.58 €**	**625,075.64 €**	**608,558.50 €**	**131,234.08 €**	**16,517.14 €**	**97.36%**

Shpenzimet e Zyres Kryetarit 16033

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11111	Paga neto	239,699.05
11121	Tatimi në te ardhurat personale	21,332.42
11131	Kontributi pensional - punëtorit	15,937.56
11151	Sindikata	496.53
11211	Pervoja e punes	19,049.45
11311	Kontributi pensional - punëdhënsit	15,937.56
11413	Shtesa e performances	25,649.35
11431	Kujdestaria, puna gjate nates dhe puna jashte orarit te punes	181.14
	Totali i pagave	**338,283.06**
13130	Transporti per udhetime zyrtare brenda vendit	761.60
13140	Transport per udhetime zyrtare jashte vendit	4,723.20
13141	para xhepi/meditjet per udhetime zyrtare jashte vendit	720.00
13142	Akomodimi per udhetime zyrtare jashte vendit	237.00
13320	Telefonia mobile	6,439.56
13440	Sherbimet keshilldhenese dhe profesionale	21,389.40
13445	Sherbimet e veqanta - konsulente dhe kontraktor individual	1,613.50
13450	Sherbimet e shtypjes / printimit	30,402.94
13503	Kompjuteret	845.00
13509	Pajisje tjera	3,115.00
13610	Furnizimet per zyre	4,828.00
13620	Furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	701.88
14022	Mirembatja e ndertesave administrative dhe afariste	15,000.00
14032	Mirembatja e rrugeve lokale	10,000.00
14040	Mirembatje e teknologjis informative dhe komunikimit	1,224.50
14050	Mirembatja e mobiljeve dhe paisjeve	5,000.00
14310	Kompensimi i perfaqesimit brenda vendit	19,428.10
14410	Vendimet gjyqesore	10,045.76
	Totali për shërbime dhe mallra	**136,475.44**
200	Subvencione dhe transfere	42,800.00
22300	vendimet gjyqesore	91,000.00
	Totali i subvencioneve	**133,800.00**
300	Investime kapitale	0.00
	Tatali i investimeve kapitale	**0.00**
	Gjithsej shpenzimet	**608,558.50 €**

Administrata dhe personeli

Kodi 16333

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	252,212.00	205,887.50	205,887.50	46,324.50	0.00	100.00%
2	Mallra dhe sherbime	88,000.00	81,307.46	70,026.98	17,973.02	11,280.48	86.13%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	**340,212.00**	**287,194.96**	**275,914.48**	**64,297.52**	**11,280.48**	**96.07%**

Shpenzimet - Administrata dhe Personeli - 16333

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11111	Paga neto	146,095.26
11121	Tatimi në te ardhurat personale	10,338.74
11131	Kontributi pensional - punëtorit	9,804.23
11151	Sindikata	552.90
11211	Pervoja e punes	12,608.42
11311	Kontributi pensional - punëdhënsit	9,804.23
11413	Shtesa e performances	16,079.26
11611	Shtesat tranzitore	604.46
	Totali i pagave	**205,887.50**
13509	Pajisjet tjera	367.50
13610	Furnizimet per zyre	7,161.00
13780	Derivatet per automjete, gjenerator dhe makineri	14,192.35
13950	Regjistrimi i automjeteve	640.00
13951	Sigurimi i automjeteve	2,044.61
13954	Kontrollimi teknik i automjeteve	120.00
14010	Mirembatja dhe riparimi i automjeteve	4,755.00
14050	Mirembatja e mobiljeve dhe paisjeve	11,527.00
14220	Botimet e publikimeve	1,020.00
14230	Shpenzimet per informim publik	5,199.52
14410	Vendime gjyqesore	23,000.00
LËNDA:	**Raport për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësit natyrore – vërshimet**	

RAPORT

Në bazë të vendimit të kryetarit të Komunës me nr 02-035/02-686 të dt. 07.07.2026 për formimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve në ekonomitë familjare dhe bujqësi nga fatkeqësit natyrore, sipas detyrave që rrjedhin nga ai vendim kemi dalur për t'i vizituar shtëpinë e banimit të Fatlum Rashitit nga Sllatina 4 ulët e dëmtuar nga vërshimet e ndodhura më 07.07.2026 në Komunën e Vitisë. Në bazë të shqimit të gjendjes në teren dhe sipas të dhënave të siguruara nga familja e dëmtuar kemi bërë një përllogaritje të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore.Dëmet e shkaktuara në objektin e banimit janë vlerësuar në bazë të çmimeve aktuale të tregut për materialet dhe punët, për të cilat duhet të investohet për rikthimin në gjendjen ekzistuese të objektit të vlerësuara nga eksperti i lëmisë së ndërtimit. Ndërsa dëmet e shkaktuara në kulturat bujqësore dhe në objektet e destinuara për aktivitete të kultivimit të tyre janë vlerësuar nga eksperti i lëmisë përkatëse.

Përshkrimi i gjendjes: Nga shirat e dendur janë shkaktuar vërshime të cilat kanë depërtuar në oborrin e shtëpisë dhe janë shkatuar dëme të konsiderueshme materiale – shembja e shtëpisë (shih fotot):















Vlerësimi i dëmeve :

Me qenë se kemi të bëjme me demolim total të objektit vlerësimi do të bëhet në bazë të sipërfaqes së objektit ekzistues dhe rindertimit të objektit për banim të sërishëm.Objekti i cili do të vlerësohet për rindërtim do të jetë Konform çmimeve aktuale të tregut, ndërsa materialet dhe punimet do të kalkulohen sipas sasive të cilat nevoiten për indërtimin e një objekti të ri I cili do të jetë I njëjtë me ate ekzistues.


Paramasa dhe parallogaria e materialeve dhe punimeve do të llogaritet sipas projektit, ndërsa kalkulimet janë të prezantuara më poshtë:

1. Rindertimi I objektit (sipas projektit ekzistues-paramasa e parallogaria): 51,485.80 €
2. Furnizimi me inventarin e ri (afersisht I njejte me ate ekzistues) : 6,750.00 €

Shuma totale: 58,235.80 €

Komisioni i vlerësimit të dëmtimeve :

1. Mustaf Islami	**kryetar i komisionit**	
2. Xhelal Musa	**anëtar i komisionit**	
3. Avni Misini	**anëtar i komisionit**	
4. Ganimete Emini	**anëtar i komisionit**	
5. Erdina Ismajli	**anëtar i komisionit**	


800
2,300
Dhome
23 m²
Paradhome
11 m²
Qendrimi ditor
37 m²
Banjo
7 m²
Terasa
55 m²
Dhome
16 m²
Dhome
12 m²
750
300
570
200
180
155
625
400
132
243
325

4.1	Furnizimi , drejtimi , prerja , lakimi ,dhe montimi i armaturës sipas llogarisë statike , detajeve te armaturës sipas lloturës dhe rregulloreve në fuqi; RBAB'87 dhe EUROCODE'92	kg	7760	1.00 €	7,760.00 €
			Gjithsejtë :		7,760.00 €

	V PUNËT E LATIMIT – MBULIMIT				
5.1	Punimi i konstruksionit të kulmit me halorë kat I-rë me gjitha shtresat e hidroizolimit (dërrasa dhe ter letër).	m^2	184	30.00 €	5,520.00 €
5.2	Mbulimi I kulmit me tjegulla	m^2	2850	1.00 €	2,850.00 €
5.3	Vendosja e ullukeve horizontal dhe vertikal	m'	62	8.00 €	496.00 €
			Gjithsejtë :		8,866.00 €

	VI PUNËT E ZDRUKTHTARISË				
6.1	I.6.1 Punimi i dritareve dhe dyerve nga plastika me ure metalike me xham vakuum dhe goma termoizoluese - komplet				
	Dritaret :				
	-140x160	copë	5	360.00 €	1,800.00 €
	-80x140	copë	2	180.00 €	360.00 €
	-80x80	copë	1	120.00 €	120.00 €
	Dyert :				
	-të hyrjes : 130x210	copë	1	400.00 €	400.00 €
	-90x210	copë	4	180.00 €	720.00 €
	-80x210	copë	2	180.00 €	360.00 €
			Gjithsejtë :		3,760.00 €

II. PUNËT NDËRTIMORE - ZEJTARE

	VII PUNËT E NGJYROSJES				
7.1	Gletimi i murit dhe i pllafonit me masë gleti dhe ngjyrosja me ngjyrë bazë .	m^2	536	1.50 €	804.00 €
7.2	Ngjyrosja e mureve dhe e pllafonit me ngjyrë ,,Polikolor " ose të ngjajshne	m^2	536	1.50 €	804.00 €
			Gjithsejtë :		1,608.00 €

	IX PUNËT E LLAMARINËS				
9.1	Mveshja e kallkaneve me llamarinë të profiluar	m'	93	9.00 €	837.00 €
9.2	Punimi dhe montimi i lugjeve -ulluqeve vertikale dhe horizontale nga llam. E zingetuar d=0.55 mm prerje 10/12 cm	m'	65	8.00 €	520.00 €
			Gjithsejtë :		1,357.00 €

	X PUNËT E DYSHEMESE				
10.1	Punimi i dyshemesë në pllaka,në Koridore dhe tualete nga qeramika (Si dhe ne muret e tualetit)	m^2	75	18.00 €	1,350.00 €
10.2	Punimi i dyshemesë nga Laminati në çmim është llogaritur edhe vendosja e llajsneve.	m^2	98	11.00 €	1,078.00 €
			Gjithsejtë :		2,428.00 €

REKAPITULIMI

I punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare

	A. PUNËT NDËRTIMORE				

	A.1 Punët tokësore	960.00 €
	A.3 Punët e betonimit	10,784.80 €
	A.2 Punët e muratimit	10,962.00 €
	A.4 Punët e armimit	7,760.00 €
	A.5 Punët e mbulimit	8,866.00 €
	A.6 Punët e zdrukthtarisë	3,760.00 €
	Punët ndërtimore gjithsejt :	**43,092.80 €**
	B. PUNËT NDËRTIMORE – ZEJTARE	
	B.1 Punët e ngjyrosjes	1,608.00 €
	B.2 Punët e llamarinës	1,357.00 €
	B.3 Punët e dyshemese	2,428.00 €
	Punët ndërtimore – zejtare gjithsejt :	**5,393.00 €**
	REKAPITULIMI TOTAL	
	1. Punët ndërtimore dhe ndërtimore – zejtare	**48,485.80 €**
	2. Ujësjellësi dhe kanalizimi dhe sanitaria –	**1,200.00 €**
	3. Instalimi elektrik –	**1,800.00 €**
	..... ***Shuma totale :***	***51,485.80 €***

	INVENTARI				
1	Tepiat	copë	4	100.00 €	400.00 €
2	dhoma e fjetjes	copë	3	800.00 €	2,400.00 €
3	Kuzhina	m	4	400.00 €	1,600.00 €
4	shporeti I rrymes	copë	1	200.00 €	200.00 €
5	frigoriferi	copë	1	200.00 €	200.00 €
6	Frizi	copë	1	300.00 €	300.00 €
7	dhoma e qndrimit ditor (rrethi)	copë	1	650.00 €	650.00 €
8	lavatrigja	copë	1	300.00 €	300.00 €
9	tavolina e ushqimit me 4 ulëse	copë	1	300.00 €	300.00 €
10	Televizori	copë	1	400.00 €	400.00 €
			Shuma totale :		**6,750.00 €**

REKAPITULLIMI TOTAL :	**58,235.80 €**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

			14-10-2026
Nr. Protokolit			Data
02	035/07	-	1159

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në mbështetje të nenit 17, shkronja a), dhe nenit 58, shkronjat h) dhe i), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Duke marrë parasysh Ligjin nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme, nenit 50 shkronja l të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit të Komunës miratimin e këtij:

PROPOZIM VENDIM

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT INSTITUCIONAL DHE MBËSHTETJEN KOMUNALE PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTIT INVESTUES NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE INFRASTRUKTURËS SË TË DHËNAVE NË LOKALITETIN E SLLATINËS, KOMUNA E VITISË

Neni 1

Qëllimi i vendimit

1. Kryetari i Komunës së Vitisë i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë të shpreh dhe jep pëlqimin e saj institucional për zhvillimin e projektit investues në fushën e teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturës së të dhënave, të propozuar nga shoqëria **DAiF SV L.L.C.**, në lokalitetin e Sllatinës, Komuna e Vitisë.

2. Përmes këtij vendimi, Komuna e Vitisë përcakton qëndrimin e saj në mbështetje të zhvillimit të projektit dhe obligon organet komunale kompetente që, brenda përgjegjësive dhe kompetencave të tyre ligjore, të ndërmarrin veprimet e nevojshme institucionale, administrative dhe planifikuese për trajtimin dhe mundësimin e realizimit të tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Projekti synon zhvillimin e infrastrukturës teknologjike për përpunimin, ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave dhe veprimtarive të ndërlidhura me teknologjinë e informacionit, sipas dokumentacionit teknik dhe investues që do të paraqitet nga investitori.

Neni 2

Lokacioni dhe parcelat kadastrale

1. Pëlqimi institucional i përcaktuar me këtë vendim lidhet me lokacionin e propozuar në lokalitetin e Sllatinës, Komuna e Vitisë, në parcelat kadastrale me numrat:

- 00924-0;
- 00926-5;
- 00925-0;
- 00926-7;
- 00926-3.

2. Kufijtë, sipërfaqja, pronësia dhe të dhënat e tjera kadastrale të lokacionit do të verifikohen nga organet kompetente gjatë procedurave përkatëse.

3. Përcaktimi i lokacionit në këtë vendim nuk paragjykon të drejtat pronësore të personave të tretë dhe nuk përbën bartje të pronësisë apo dhënie të së drejtës së shfrytëzimit të parcelave.

Neni 3

Dhënia e pëlqimit institucional për zhvillimin e projektit

1. Kuvendi i Komunës së Vitisë jep pëlqimin institucional për zhvillimin e projektit investues të përcaktuar në nenin 1 të këtij vendimi dhe për vazhdimin e procedurave të nevojshme institucionale me qëllim të realizimit të tij.

2. Pëlqimi nga paragrafi 1 i këtij neni përbën qëndrimin zyrtar të Komunës së Vitisë në mbështetje të projektit dhe bazë për veprimet e mëtejme të organeve komunale, brenda kompetencave të tyre ligjore.

3. Komuna e Vitisë obligohet që, nëpërmjet organeve të saj kompetente, të bashkëpunojë me investitorin dhe institucionet përgjegjëse qendrore për identifikimin, përgatitjen dhe zhvillimin e procedurave të nevojshme për realizimin e projektit.

4. Ky pëlqim nuk zëvendëson vendimet, pëlqimet, kushtet ndërtimore, lejet mjedisore, lejet ndërtimore ose autorizimet e tjera që kërkohen me legjislacionin në fuqi dhe që lëshohen nga organet kompetente

Neni 4

Obligimet e organeve komunale

1. Kryetari i Komunës obligohet të ndërmarrë veprimet institucionale brenda kompetencave të tij për zbatimin e këtij vendimi dhe për koordinimin e veprimeve të drejtorive komunale përgjegjëse.

2. Drejtoria kompetente për Urbanizëm, Planifikimt dhe Mbrojtje të Mjedisit obligohet që:

a) të trajtojë projektin si projekt të mbështetur institucionalisht nga Kuvendi Komunal i Vitisë;
b) të identifikojë procedurat e nevojshme për harmonizimin e projektit me Hartën Zonale Komunale, duke marrë parasysh statusin juridik dhe fazën procedurale të këtyre dokumenteve;
c) t'i trajtojë kërkesat dhe dokumentacionin e projektit me prioritet administrativ, pa cenuar procedurat dhe afatet e detyrueshme ligjore.
Organet komunale obligohen që të mos e trajtojnë projektin si kërkesë pa mbështetjen institucionale të Komunës, por si projekt për të cilin Kuvendi ka shprehur qëndrim pozitiv, duke i zhvilluar procedurat e mëtejme sipas ligjit

Neni 5

Trajtimi në kuadër të Ligjit për Investime të Qëndrueshme

1. Komuna e Vitisë mbështet shqyrtimin e projektit në kuadër të Ligjit nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme dhe bashkëpunimin me institucionet qendrore kompetente për përcaktimin e mundësive dhe kushteve të trajtimit të tij sipas këtij ligji.

2. Për këtë qëllim, investitori do të paraqesë dokumentacionin për vlerën e investimit, burimet e financimit, kapacitetet financiare dhe teknike, planin e realizimit, numrin e vendeve të punës që synohet të krijohen dhe dokumentacionin tjetër që kërkohet nga institucionet kompetente.

3. Komuna do të ofrojë bashkëpunimin dhe dokumentacionin që i takon, si dhe do t'i drejtohet institucioneve kompetente për sqarimin e procedurës përkatëse.

4. Dhënia eventuale e statusit të investimit të qëndrueshëm dhe përfitimi nga mekanizmat e paraparë me ligj mbeten në kompetencën e institucioneve të përcaktuara me legjislacionin përkatës.

Neni 6

Trajtimi i projektit në dokumentet e planifikimit hapësinor

1. Duke marrë parasysh karakterin e projektit dhe rëndësinë e mundshme për zhvillimin ekonomik të Komunës së Vitisë, organet komunale obligohen që të shqyrtojnë mundësitë ligjore për përfshirjen dhe trajtimin e tij në dokumentet përkatëse të planifikimit hapësinor.

2. Duke qenë se Harta Zonale Komunale është në proces të hartimit, Drejtoria kompetente obligohet të vlerësojë nëse projekti mund të merret në konsideratë gjatë këtij procesi, në përputhje me fazën e hartimit, kërkesat profesionale, konsultimin publik dhe procedurat ligjore të zbatueshme.

3. Nëse realizimi i projektit kërkon ndryshimin ose plotësimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor në fuqi, Komuna obligohet të shqyrtojë dhe të iniciojë procedurën përkatëse, nëse plotësohen kushtet ligjore dhe nëse një procedurë e tillë është e lejueshme sipas legjislacionit në fuqi.

4. Asnjë dispozitë e këtij neni nuk interpretohet si ndryshim i drejtpërdrejtë i destinimit të tokës ose i dokumenteve të planifikimit hapësinor vetëm nëpërmjet këtij vendimi.

Neni 7

Vlerësimi i ndikimeve dhe kushtet për realizim

1. Gjatë procedurave të mëtejme, do të vlerësohen ndikimet e projektit në mjedis, tokë, ujë, energji, infrastrukturë, komunikacion dhe komunitetin lokal, në përputhje me kërkesat ligjore.

2. Investitori obligohet të sigurojë dokumentacionin, studimet, pëlqimet dhe lejet e kërkuara për realizimin e projektit.

3. Pëlqimi institucional i dhënë me këtë vendim nuk përjashton detyrimin për respektimin e kërkesave ligjore për mbrojtjen e tokës, mjedisit, shëndetit publik, sigurisë dhe interesit publik.

Neni 8

Zbatimi dhe raportimi

1. Për zbatimin e këtij vendimi përgjegjës janë Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë Komunale Kompetente, secila brenda fushëveprimit të përgjegjësive të veta ligjore.

2. Kryetari i Komunës siguron koordinimin e veprimeve institucionale dhe mund t'i kërkojë drejtorive përkatëse raport për veprimet e ndërmarra dhe procedurat e zhvilluara.

3. Kur për realizimin e projektit kërkohet vendimmarrje nga institucione të tjera, Komuna bashkëpunon me to dhe përcjell kërkesat e nevojshme brenda kompetencave të saj.

Neni 9

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

ARSYETIM

Komunës së Vitisë i është paraqitur kërkesë nga shoqëria DAiF SV L.L.C., e datës 06.10.2026, për trajtimin me prioritet të një projekti investues të propozuar në lokalitetin e Sllatinës, në parcelat kadastrale të evidentuara në këtë vendim.

Projekti, sipas përshkrimit paraprak të paraqitur, synon zhvillimin e infrastrukturës në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të të dhënave. Një investim i kësaj natyre mund të krijojë mundësi për zhvillim ekonomik, punësim dhe zgjerim të veprimtarive teknologjike në Komunën e Vitisë, me kusht që përfitimet dhe realizueshmëria e tij të dokumentohen gjatë procedurave përkatëse.

Në dokumentacionin e paraqitur përmendet gjithashtu një shkresë e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës lidhur me interesin për një projekt të qendrës së të dhënave në Kosovë. Kjo shkresë mund të merret në konsideratë si dokument kontekstual, por lidhja e drejtpërdrejtë e saj me projektin e propozuar nga DAiF SV L.L.C. duhet të verifikohet dhe ajo nuk përbën vetvetiu miratim, garanci financimi apo autorizim për realizimin e projektit.

Duke marrë parasysh Ligjin nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme dhe rëndësinë që mund të ketë projekti për zhvillimin ekonomik lokal, vlerësohet e arsyeshme që Kuvendi Komunal i Vitisë të japë pëlqimin institucional për zhvillimin e tij dhe të obligojë organet komunale të ndërmarrin veprimet e nevojshme brenda kompetencave ligjore.

Njëkohësisht, duke pasur parasysh dokumentet e planifikimit hapësinor në fuqi dhe procesin e hartimit të Hartës Zonale Komunale, është e nevojshme që përputhshmëria e lokacionit dhe mundësia e përfshirjes së projektit në dokumentet përkatëse të shqyrtohen sipas procedurave ligjore.

Për këto arsye, i propozohet Kuvendit të Komunës së Vitisë miratimi i këtij propozim vendimi, me të cilin Komuna shpreh pëlqimin institucional për zhvillimin e projektit dhe obligon organet e saj kompetente të ndërmarrin veprimet e nevojshme për trajtimin dhe mundësimin e realizimit të tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
19-10-26
02-075/02-1167

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjën Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenit 50 shkronja 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

për ngritjen e obeliskut Deshmoret dhe Martiret e Verbanit

Neni 1

Kryetari i Komunës së Vitisë i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që ta miraton propozim vendimin për ngritjen e obeliskut Deshmoret dhe Martiret e Verbanit.

Neni 2

Shpenzimet për rregullimin e obeliskut Deshmoret dhe Martiret e Verbanit kryhen nga banoret e fsh.Verban.

Neni 3

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

			14-10-2026
02	035/02		1158

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjën Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, në harmoni me Strategjinë për Migrim 2021-2025, te aprovuar nga Qeveria e Republikës se Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020, për Riintegrimin e personave te Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregullore (QRK) Nr. O9/2019 për Integrimin e te Huajve, nenit 50 shkronja l të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për miratimin e planit komunale për ri integrimin e qëndrueshëm të personave te riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Vitisë 2026-2028

Neni 1

Kryetari i Komunës së Vitisë i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që ta miraton propozim vendimin për miratimin e planit komunale për ri integrimin e qëndrueshëm të personave te riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Vitisë 2026-2028.

Neni 2

Pjese përbërëse e këtij propozim vendimi është draft planit komunale për ri integrimin e qëndrueshëm të personave te riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Vitisë 2026-2028.

Neni 3

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do te kujdeset Kryetari i Komunës, Zyra për Komunitete dhe Kthim ne Komunën e Vitisë.

Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e
Opstina Vi
Municipali

PLANI KOMUNALP PËR RI INTEGRIMIN E QËNDRUSHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE INTEGRI
HUAJVE NË KOMUNËN E VITISË
2026-2028

Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimit të të huajve në Vi
2026 - 2028

Duke u bazuar në nenin ..... të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në harmoni Strategjinë për Migrim 2021 - 2025 të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosu Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, date 11.07.2019) nenin .....të statusit të Komunës se Vitise, K i Komunës së Vitisë në mbledhjen e Mbajtur më _____ 2026, aprovoi:

Shkurtesat

ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
APRK	Agjensioni i Punësimit i Republikës së Kosovës
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
DRPRIH	Departamenti për Ri integrim të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EPPRM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim për Mosbraktisje
KA	Komisioni për Ankesa
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KKR	Komisioni Komunal për Ri integrim
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës,Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
PR	Person i Riatdhesuar
PIR	Plani Individual i Ri integrimit
PII	Plani Individual i Integrimit
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
QPS	Qendrat për Pune Sociale
SMR	Sistemi për Menaxhimin e Rasteve

ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZP	Zyrat e Punësimit
ZGJC	Zyra e Gjendjes Civile

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka aprovuar Strategjinë për Mingrim 2021 - 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe ba në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vend nr. 01/110, date 11.07.2019).

Në kuadër të Agjendës Evropiane të Kosovës, kriteret nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave të përcaktuara në Bllokun 0, Ri pranimi dhe Ri integrimi tashmë përmbushur. Gjatë hartimit të Strategjisë për Ri integrim, janë adresuar të gjitha kërkesat që dalin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Strategjia e Ri integrimit ka për qëllim ri integrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemi efektiv e efikas të shërbimeve, të fokusuar në nevojat e të kthyerve.

Strategjia, si dokument qeveritar i politikave të ri integrimit është obligative të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Planit te Veprimit te Strateg është paraparë edhe hartimi i Planeve Komunale për Ri integrim të qëndrueshëm. Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë për Migrim 2022 - 2025, Z Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale si dhe me përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare, si Grupi Pun kanë hartuar Planin Komunal për ri – integrim të qëndrueshëm dhe Integrimin e të huajve për Komunën e Vitisë.

Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objek saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve, indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteteve dhe mj e verifikimit.

Plani është hartuar në bazë të Strategjisë për Mingrim 2021 – 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregullo për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, d 11.07.2019) dhe Planit të veprimit në nivel shtetëror, në bashkëpunim të ngushtë me MPB/DRPRIH si institucion përgjegjës për ri integrim në nivel nacional, dhe në v ngërthen strukturën e saj, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riatdhesuar në Komunën e Vitisë, përmban edhe aktivitetet specifike për v komunën dhe është e bazuar në të dhënat e siguruara nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Kështu, ne këtë Plan është mundësuar integrimi maksimal i gji aktiviteteve për arritjen e ri integrimit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Vitisë.

Plani Komunal i Veprimit për riintegrimin dhe integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huaj 2026-2028

Objektivi 1:	*Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit*	*Baza*	*Caku 2026*	*2028*
Avancimi i sistemit të ri integrimit për personat e riatdhesuar, duke aplikuar qasjen e orientuar në nevojat specifike për riintegrimin e personave te riatdhesuar dhe integrimin e të huajve	• *Janë identifikuar nevojat e grupeve të cenueshme dhe shërbimet ofrohen bazuar në planin individual të riintegrimit dhe te integrimit;*	*40%*	*60%*	*80*
	• *Shërbimet e riintegrimit dhe integrimit monitorohen sistematikisht dhe ndërmerren masat e nevojshme përmirësuese;*	*50%*	*70%*	*80*
	• *Është arritur riintegrimi dhe i integrimit qëndrueshëm socio ekonomik i grupeve të cenueshme;*	*30%*	*50%*	*70*

#	**Masa**	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikim***
1.1	Identifikimi i nevojave të grupeve të cenueshme;	1. Realizimi i vizitave në familjet e kthyera, apo të posa ardhurve të huaj brenda 72 orëve pas kthimit, apo pas marrjes së statusit/leje qëndrimit në Kosovë, bashkërisht me përfaqësuesin e DRPRIH dhe QPS; 2. Intervisto familjen dhe plotëso formularin e Vlerësimit të Nevojave;	NR. i familjeve të cenueshme të kthyera, dhe të huaja në komunë Nr. vizitave të realizuara nga ekipi për VN Nr. i FVN të plotësuar Nr. i formularëve të vendosur në SMR	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS DRPRIH/MPB Specialist shëndetësor Policia në komunitet - (Sipas nevojës) Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Raporte terer FVN i Plo dhe nënsl nga pa SMI

		3. Vendos FVN të skanuar në SMR						
1.2	Hartimi i planit individual të ri integrimit dhe integrimit, bazuar në pakot standarde të shërbimeve dhe nevojat e identifikuara ne FVN;	Harto Planin Individual të ri integrimit dhe integrimit për secilin person dhe familje të cenueshme, në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë përkatëse komunale; Vendose PIR/PII të skanuar në SMR;	Nr. i Planeve Individuale të ri integrimit dhe integrimit, të hartuara;	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Plan Individ ri integri integrim SM
1.3	Zbatimi i planit individual të ri integrimit dhe integrimit përmes ofrimit i shërbimeve të ri integrimit të qëndrueshëm për grupet e cenueshme;	Këshillo personin e riatdhesuar dhe të huajin për parashtrim të kërkesave dhe informoje për afatet ligjore te parashtrimit te kërkesave; Ndihmo PR në plotësimin e kërkesave dhe dokumentacionit; Bashkëpuno me drejtoritë përkatëse komunale për sigurimin e shërbimeve të nevojshme; Regjistro kërkesat dhe përfitimet në	Nr. i kërkesave te parashtruara, bazuar në PIR; Nr. dhe llojet e skemave të mbështetjes; Nr. i kërkesave dhe përfitimeve të regjistruara ne SMR;	ZKKK DRPRIH/MPB	Drejtoritë komunale përkatëse DRPRIH/MPB ZP QAP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	BRK - Buxheti i ri integrimit dhe integrimit	Në vazhdimësi	Rapon rregu Kërkes parashtr SMI

		SMR;						
1.4	Monitorimi dhe vlerësimi periodik i ri integrimit dhe integrimit të qëndrueshëm për grupet e cenueshme;	Monitoro në baza mujore zbatimin e PIR; Vlerëso në baza tremujore skemat e ofruara, ndikimin e tyre dhe nevojat për plotësime apo ndryshime të skemave për arritjen e ri integrimit të qëndrueshëm dhe integrimit;	Nr. i raporteve mujore të monitorimeve dhe vlerësimeve; Raporti tremujor i vlerësimit të ndikimit te skemave të ri integrimit dhe integrimit, me rekomandimet konkrete për masa shtesë, në rast nevoje;	ZKKK DRPRIH/MPB	Drejtoritë komunale përkatëse ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Rapor tremuj monitori vlerës
1.5	Vlerësimi përfundimtar i ri integrimit dhe integrimit dhe mbyllja e rastit;	Vlerëso gjendjen përfundimtare dhe nivelin e ri integrimit dhe integrimit te PR sipas PIR; Mbylle rastin në dokumentacion fizik; Mbyll rastin në SMR- konstato - ri integrim / integrim i qëndrueshëm;	Nr. i raporteve të vlerësimit përfundimtar për secilin person/familje; Numri i rasteve të mbyllura në dosje fizike; Numri i rasteve të mbyllura në dosje fizike SMR	ZKKK	DRPRIH/MPB ZP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Raport mbyllj rasteve p muaj Dosjet fi PR, të ml SMI

Objektivi specifik: 2	***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***	***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Avancimi i sistemit të referimit të rasteve në skemat adekuate të ri integrimit të personave të riatdhesuar dhe integrimit të të huajve	• *Sistemi i referimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve komunal është i vendosur dhe funksional;*	*40 %*	*70%*	*90%*
	• *Numri i rasteve të referuara tek autoritetet relevante komunale, bazuar në profilin e tyre është rritur;*	*40 %*	*75%*	*90%*

			• *Rritet numri i drejtorive komunale të ndërlidhura me SMR*			*30 %*	*60 %*	*80 %*
#	***Masa***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjete verifik***
2.1	Vendosja e një sistemi funksional të referimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve komunal;	Koordino ndihmën dhe mbështetjen me drejtoritë relevante komunale, ne baza ditore, për secilin rast; Realizo takime te rregullta dhe takime ad-hoc, diskuto rastet që kërkojnë zgjidhje;	Nr. i rasteve të referuara ne drejtorit përkatëse komunale; Nr. i takimeve te rregullta dhe numri i rasteve te diskutuara; Nr. i takimeve ad –hoc dhe numri i rasteve te diskutuara;	ZKKK DRPRIH/MPB	DRPRIH/MPB MAPL MFPT MSH MBPZHR QPS ZP Drejtoritë komunale përkatëse Qendra e Shëndetit mendor Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	SMI Raport rregullt terer Raport rregullt DRPRIH ZKK
2.2	Profilizimi i të riatdhesuarve dhe të huajve, vlerësimi i nevojave pas arritjes në komuna;	Pranimi në zyrë i personave të riatdhesuar apo të huaj; Intervisto të riatdhesuarin/të huajin, parashtro pyetje rreth nevojave dhe mundësive të	Nr. i personave të lajmëruar në ZKKK; Nr. i personave të intervistuar; Nr. i dosjeve me profilin personave të riatdhesuar dhe te huaj;	ZKKK DRPRIH/MPB	DRPRIH/MPB ZP Drejtoritë përkatëse komunale	KA	Në vazhdimësi	Raport DRPRIH ZKK SMI

		tij/saj; Krijo profilin e secilit person të kthyer apo te huaj; Vlerëso dhe evidento nevojat e tij/saj; Vendos profilin dhe nevojat në SMR;	Nr. i personave me nevojat e vlerësuara; Nr. i personave me profilin e vendosur ne SMR					
2.3	Referimi i personave të riatdhesuar dhe të huajve tek autoritetet relevante komunale bazuar në nevojat dhe profilin e tyre;	Refero personat në drejtoritë përkatëse për marrjen e shërbimeve p.sh: Refero në ZGJC personat qe kanë nevojë për dokumentacion civil; Refero personat e kthyer, apo të huaj në ZP që të regjistrohen si punëkërkues; Refero personat e kthyer apo të huaj të cenueshëm në QPS; Refero në DKA personat e kthyer apo të huaj që kanë fëmije për informim dhe asistimin e tyre për regjistrimin e tyre në shkolla;	Nr.i personave të referuar në drejtoritë përkatëse; Nr .i personave te referuar në ZGJC; Nr.i personave te referuar në ZP; Nr.i personave te referuar në QPS; Nr.i personave te referuar në DKA;	ZKKK	DRPRIH ZP QPS QAP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Rapor DRPRIH ZKK SMI

2.4	Përmirësimi i sistemit të këshillimit të personave të riatdhesuar apo të huaj pas arritjes në komunë;	Bazuar në profilin dhe nevojat, këshillo ata për mundësitë e përfitimit nga shërbimet publike dhe skemat e ri integrimit dhe të integrimit; Këshillo dhe oriento ata se cilat dokumente ju nevojiten për çfarë shërbimi; Ndihmo ne përgatitjen dhe kompletimin e kërkesave; Këshillo për respektimin e afateve dhe detyrimet ligjore; Njofto ata për pasojat ligjore të ri emigrimit;	Nr. i personave të këshilluar nga ZKKK Nr. i personave qe janë ndihmuar për përgatitjen dhe kompletimin e dokumenteve	ZKKK	DRPRIH/MPB QPS ZP ZP QAP Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Raport DRPRIH ZKK SM
2.5	Ndërmarrja e masave me akterët relevant për gjurmim, referim dhe këshillim të personave të riatdhesuar dhe të huaj;	Vendos sistem të bashkëpunimit të rregullt me Policinë në komunitet, me grupet në komunitet, me shkollat, organizatat; Kërko që të	Takimet e rregullta me akterët relevant Numri i të riatdhesuarve	ZKKK	DRPRIH Policia e Kosovës Shkollat ZP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat	/	Në vazhdimësi	Raport DRPRIH ZKK Numri riatdhes dhe te hu identifi

		informohesh nëse ndonjë person apo familje është kthyer/ apo person apo familje e huaj ka marre statusin e mbrojtjes ndërkombëtare apo leje qëndrim, e nuk është identifikuar në SMR dhe/apo nuk është lajmëruar në zyrën tuaj; Kontakto personin e kthyer apo te huajin informo për mundësitë e mbështetjes, refero në institucionet përkatëse;	dhe te te huajve që identifikohen si rezultat i këtij bashkëpunimi		vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
2.6	Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit të referimit dhe koordinimit;	Realizo takime te rregullta me ZKKK; Diskutoni për referimin dhe koordinimin e rasteve; Analizo sistemin e referimit dhe koordinimit; Vlerëso gjendjen aktuale dhe Rekomando masa përmirësuese, në rast nevoje;	Nr. i takimeve të rregullta	ZKKK DRPRIH/MPB	ZP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Rapor monitor

2.7	Referimi i rasteve pas periudhes 12 mujore sipas legjislacionit në fuqi.	Identifikimi i personave / familjeve qe kane nevoje per mbeshtetje pas 12 muajve. Ndërmarrja e veprimeve për planifikim buxhetor për vazhdimin e akomodimit dhe masave tjera te nevojshme pas 12 muajve.	Vizita personave / familjeve në skemën e akomodimit dhe me nevoja specifike pas periudhes 12 mujore Takime dhe informim për rastet me drejtoritë përgjegjëse në mënyrë që të bëhet planifikimi buxhetor	ZKKK QPS Drejtoritë përgjegjëse	DRPRIH ZP	/	Në vazhdimësi	Raport rregul
Objektivi specifik 3			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Avancimi i masave të ri integrimit dhe integrimit të qëndrueshëm ekonomik			• *Numri i punëkërkuesve të riatdhesuar apo te huaj të profilizuar dhe të këshilluar për zhvillimin në karrierë;* • *Numri i të riatdhesuarve/huajve të punësuar;* • *Numri i përfituesve të vetëpunësimit dhe shërbimeve të konsulencës;* • *Numri i përfituesve nga skemat e aftësimit profesional;* • *Numri i të riatdhesuarve/te huajve përfitues të granteve bujqësore dhe këshillimeve në fushën e bujqësisë;* • *Numri i të riatdhesuarve/te huajve të mbështetur nga komuna me material dhe mjete bujqësore;*			***60%***	***70%***	***90%***

			• *Zgjerimi i fushave të aftësimit profesional në përputhje me nevojat e tregut*					
%	***Masat***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet verifikë***
3.1	Regjistrimi i të riatdhesuarve/të huajve si punëkërkues në Zyrat e Punësimit;	Prano në zyrë personin e riatdhesuar/të huaj; Regjistro personat e riatdhesuar/te huaj si punëkërkues; Informo ata për të drejtat e tyre dhe mundësitë e mbështetjes me MATP; Informo ata për mundësitë e tyre në baze të legjislacionit në fuqi;	Nr. i personave të riatdhesuar apo te huaj të regjistruar si punëkërkues;	APRK ZP	DRPRIH/MPB ZKKK QAP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet Raportet e
3.2	Profilizimi dhe këshillimi për zhvillim në karrierë i punëkërkueseve të riatdhesuarve apo te të huajve;	Intervisto atë, parashtro pyetje rreth mundësive dhe nevojave të tij/saj; Vlerëso dhe evidento nevojat e tij/saj Krijo profilin e secilit person të kthyer apo të huaj Këshillo ata për orientim ne karriera, bazuar ne aftësitë dhe mundësit e tyre	Numri i personave të riatdhesuar, te huaj të cilëve u janë vlerësuar nevojat e tij/saj; Nr i dosjeve fizike të personave të riatdhesuar apo te huaj që janë këshilluar në ZP dhe nevojat e tyre jane evidentuar; Numri i të riatdhesuarve apo te huajve punëkërkues ku janë	ZP	ZKKK QAP	/	Në vazhdimësi	Raportet Numri i d Shënimë raportet SMI

		Krijo një dosje për secilin person te riatdhesuar apo te huaj Vendos shënimet në SMR	vendosur shënimët për profilizim dhë këshillim në SMR					
3.3	Punësimi i të riatdhesuarve apo te huajve përmes ndërmjetësimit në punësim;	Ndërmjetëso në punësim personat e riatdhesuar apo ata te huaj të përgatitur për tregun e punës; Evidento të dhënat relevante në SMR;	Numri i rasteve të ndërmjetësuara Numri i rasteve të punësimit të riatdhesuarve apo te te huajve me ndërmjetësim Të dhënat për ndërmjetësim dhe punësim në SMR	ZP	DRPRIH ZKKK APRK Bizneset Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë (donatoret)	/	Në vazhdimësi	Raportet me të dh mbi num rasteve ndërmjetë dhe punës personar riatdhesu atyre te
3.4	Trajnimi në punë dhe punësimi i të riatdhesuarve apo te te huajve përmes subvencionimit të pagës;	Ndërmjetëso për trajnim përmes punës personat ne nevojë për përgatitjen për tregun e punës; Monitoro mbarëvajtjen e trajnimit dhe punësimit;	Numri i rasteve të ndërmjetësuara për trajnim dhe përgaditje për tregun e punës; Numri i rasteve të monitoruara	ZP QAP	DRPRIH ZKKK Bizneset Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet dhe QAP
3.5	Vetëpunësimi i të riatdhesuarve apo te të huajve përmes financimit të planeve të biznesit;	Informo këta persona për mundësitë dhe kushtet e përfitimit nga kjo skemë; Informo keta persona	Numri i të riatdhesuarve apo te te huajve që informohen për mundësitë dhe kushte e përfitimit përmes planeve të biznesit	ZP	DRPRIH ZKKK QAP Organizatat vendore dhe	/	Në vazhdimësi	Raport ZKK

		kur thirrja të jetë e hapur për aplikim; Ndihmo këta persona në kompletimin e dosjes për aplikim;			ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
3.6	Aftësimi profesional i personave të riatdhesuar dhe te te huajve në përputhje me kërkesat e tregut të punës;	Identifiko personat e riatdhesuar dhe te huaj që kanë nevojë për aftësim profesional; Identifiko profilin e tyre dhe orientoj ata ne profesionet adekuate me pirjet dhe dëshirat e tyre; Referoj ata në QAP përkatëse;	Numri i të riatdhesuarve apo te huajve që vijojnë aftësimin profesional Numri i të riatdhesuarve apo te huajve të profilizuar dhe orientuar për AP Numri i të riatdhesuarve apo te huajve që referohen në QAP	ZP QAP	DRPRIH ZKKK Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Bizneset	/	Në vazhdimësi	Raportet me të dhë të riatdhes dhe të huaj vijojn aftësim profesio
3.7	Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i zbatimit të Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP);	Monitoro në baza të rregulltambarëvajtjen e Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP); Vlerëso ndikimin e tyre ne përgatitjen dhe ri integrimin e PR;	Numri i të riatdhesuarve de te huajve që përfitojnë nga MATP ; Të dhëna për ndikimin e MATP në riintegrimin dhe integrimin e tyre	ZP DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal)	ZKKK APRK Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Rapor periodik monitorim vlerësim përgatitu DRPRIH. (Koordinato Rajonal)
3.8	Mbështetja me grante, mjete dhe materiale bujqësore, trajnimi dhe këshillimi i të	Informimi i të ketyre personave për mundësitë e përfitimit të granteve bujqësore;	Numri i të riadhesuarve dhe te huajve që kanë përfituar grante bujqësore	Drejtorati i Bujqësisë dhe Zhvillimit rural/ Komuna	ZKKK AZHBR/MBZHR Drejtoritë përkatëse komunale	/	Në vazhdimësi	Raport ZKKK i dhënat pë kur përfit granteve person

	riatdhesuarve dhe te huajve në zonat rurale;	Përfshirja e të riatdhesuarve dhe te huajve si përfitues i granteve bujqësore;			Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			riatdhe
Objektivi specifik 4			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Avancimi i sistemit për ri integrim dhe integrim të mirëqenjës sociale të personave të riatdhesuar dhe te huajve			*Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për përfitim nga shërbimet sociale;*			*40 %*	*75%*	*90%*
			Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve përfitues të asistencës sociale;			*50%*	*70%*	*90%*
			Numri i personave të riatdhesuar dhe personave te huaj në nevoje që kanë pranuar trajtim psiko-social;			*%*	*30%*	*50%*
			Numri i personave të riatdhesuar dhe personave te huaj të përfshirë në aktivitetet kulturore, sociale, rekreative dhe inovative ;			*10 %*	*30%*	*60%*
			Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që u është siguruar banim i qëndrueshëm nga komunat (pas periudhës 12 mujore);			*10%*	*30%*	*50%*
			Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që kanë përfituar asistencë në sigurimin e kushteve për banim;			*30%*	*50%*	*60%*
#	***Masa***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afatet kohore***	***Mjete verifik***
4.1	Informimi dhe këshillimi social i personave të riatdhesuar dhe te huajve për mundësitë e përfshirjes në skemat sociale;;	Prano në zyre personin e riatdhesuar apo te huaj, te referuar nga ZKKK; Informo atë për shërbimet dhe	Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve që u ofrohet këshillë për shërbimet dhe skemat sociale; Numri i rasteve që monitorohen derisa	QPS	ZKKK DRPRIH/MPB (Koordinuon Rajonal) ZP Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat	/	Në vazhdimësi	Raporte QP Raport ZKK

		skemat sociale; Këshilloje atë për procedurat dhe dokumentet e nevojshme për përfshirje sociale; Menaxho rastin deri ne vendosjen ne sistemin social; Regjistroi ne bazën e te dhenave (SNS) rastin/skemën e përfitimi;	vendosen në sistemin social Vendosja e të dhënave për të riatdhesuarit dhe te huajt që përfitojnë nga skemat sociale në SMR		veKKRndore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
4.2	Asistimi i personave të riatdhesuar dhe te huaj në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm.	Të përfshihet zyra e gjendjës civile si pjesë e KKR-së. Asisto personat e riatdhesuar dhe personat e huaj për sigurimin e dokumenteve te nevojshme për aplikim skemat sociale si dhe ndihma juridike falas Menaxho dhe monitoro rastin në shqyrtimin e kërkesës dhe vendimin përfundimtar; Regjistroi ne SMR	Vendimi i KKR-së plotësuar dhe ndryshuar nga komuna Numri i personave të riatdhesuar dhe te huajve që asistohen për përgaditje të dokumentacionit për aplikim në skemat sociale dhe ndihme juridike falas Numri i rasteve të monitoruara deri në shqyrtim të kërkesës deri te vendimi përfundimtar Vendosja e të dhënave për numrin e të riatdhesuarve dhe te huajve që	Komuna KKR QPS	ZKKK DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal) ZP Drejtoritë përkatëse komunale Agjensioni për ndihmë juridike falas	/	Në vazhdimësi	Raportet QPS Raport ZKK

		rastin/skemën e përfitimit;	përfitojnë nga skemat sociale në SMR					
